1. Ligji nr. 80, datë 22/09/2015, " Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë";
2. VKM Nr. 418, datë 10.5.2017, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë ose të Programeve të tyre të Studimit"
3. Ligji nr. 80/2015, " Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë";
4. Vendimi Nr.185 datë 25.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.01.2018, në lidhje me elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, në të cilin citohet b) *Studimet e doktoratës organizohen në fusha/nën-fusha kërkimi. Ato përfshijnë veprimtari të kërkimit shkencor me qëllim që të sigurojnë formimin në fushën përkatëse të studimit.*;
5. VKM Nr. 112, datë 23/02/2018, "Për përcaktimin e kriterëve për marrjen e titullit akademik "Doktor" dhe standardeve shtetërore për marrjen e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor";
6. Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.52, datë 3/12/2015, " Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare për pranimin në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në Institucionet e Arsimit të Lartë";
7. Urdhri i Ministrit të Arsimit nr. 20, datë 22.09.2017, mbi një ndryshim në Urdhrin nr. 52, datë 3/12/2015, "Për përcaktimin e njohjes së gjuhëve të huaja dhe testeve ndërkombëtare për pranimin në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar.



Neni 2

Objekti i Rregullores

Kjo rregullore është e zbatueshme për studimet e ciklit të tretë Doktoratë në “ARKITEKTURË MESDHETARE: PROJEKTI, NJOHJA DHE RUAJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE”, një program formues ndërkombëtar që drejtohet së bashku me Universitetin e Firences (Departamenti i Arkitekturës) dhe i mundëson të regjistruarve në programet e doktoratës, përmes mobilitetit dhe mbikëqyrjes së përbashkët, të kryejnë kërkimet e tyre shkencore në periudha alternative në të dyja institucionet dhe pas përfundimit të ciklit të studimeve dhe me një mbrojtje të vetme të tezës, të marrin titullin e dyfishtë “Doktor”. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i objektivave, ndarja e përgjegjësisë, përcaktimi i kritereve të pranimit, procedurave të regjistrimit dhe kritereve të nevojshme për marrjen e titullit akademik "Doktor".

Neni 3

Institucionet e interesuara

1. **Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë (Fakulteti i Shkencave të Aplikuara)** me seli ligjore në Tiranë (Shqipëri), Rruga Dritan Hoxha, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar ligjërisht nga Rektori prof. Leonardo Palombi, i lindur në Romë më 28/04/1954,
2. **Universiteti i Firences (Departamenti i Arkitekturës)**, me seli ligjore në Firenze (Itali), Piazza San Marco, 4, Kod Tatimor 01279680480, përfaqësuar ligjërisht nga Rektoria prof. Alessandra Petrucci, e lindur në Milano më 10/03/1962,

Neni 4

Objektivat e Programit të Doktoratës

4.1 Objektivat e përgjithshme të Programit të Doktoratës

Doktorata ka një rëndësi të veçantë ndërkombëtare dhe ka për qëllim formimin shkencor dhe profesional të doktorantëve, duke mbështetur formimin dhe kualifikimin e tyre në hartimin e projekteve individuale në fushat e studimit të interesit kërkimor të përcaktuara nga Njësia bazë ose Njësia kryesore. Këto studime janë themelore për kërkimin shkencor dhe për veprimtarinë kreative, për përvetësimin e metodologjive kërkimore, përdorimin dhe përpunimin e burimeve informative, përfitimin e terminologjisë së specializuar në fushën e kërkimit shkencor.

Doktorantët dhe doktorantet e regjistruar në programet e doktoratës: “Arkitekturë, Projekti, Njohja dhe Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore” në Universitetin e Firences dhe: “Arkitekturë Mesdhetare: Projekti, Njohja dhe Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore” në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë, mund të marrin pjesë në programin e mobilitetit të parashikuar në marrëveshjen ndërkombëtare të bashkë-drejtimin të nënshkruar midis palëve.

Objekti i përfundimtar është të formohen kërkues shkencorë të aftë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe për të kryer në mënyrë të pavarur aktivitetin e kërkimit shkencor.



Në përfundim të programit të Doktoratës, doktorantët do të kenë fituar aftësi komunikimi shkencor, të cilat do t'i ndihmojnë të zhvillojnë dhe të ruajnë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e punës.

4.2 Objektivat specifike të Programit të Doktoratës

Objektivi përfundimtar i këtij programi studimi është të përgatisë doktorantin të analizojë dhe përpunojë rezultatet e kërkimit dhe të formojë kërkues shkencorë shumë të kualifikuar dhe inovativë, të aftë të zhvillojnë projekte kërkimore origjinale dhe me rëndësi në fushën e arkitekturës, duke përfshirë përvetësimin e aftësive kritike dhe analitike, si dhe aftësinë për të përballuar dhe zgjidhur probleme komplekse përmes qasjeve ndërdisiplinore.

Objektivi kryesor strategjik i Doktoratës është kujdesi dhe vlerësimi i qëndrueshëm të trashëgimisë territoriale, nga qytetet dhe vendbanimet, te çdo ndërtesë dhe sistem kulturor jomateriale, që pasurojnë dhe mbështesin identitetin e tyre. Synon të formojë kërkues shkencorë dhe profesionistë të nivelit të lartë, të aftë të ndjekin dhe të transmetojnë njohuritë e integruara të fushave disiplinore të lidhura me qëllimin e përcaktuar, si dhe të bashkëpunojnë me një qëndrim proaktiv dhe ekzekutiv me Entet dhe Institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare të përfshira. Qëllimi specifik është njohja, ruajtja dhe vlerësimi i trashëgimisë kulturore që, në të gjitha format dhe diversitetin e saj, përbën një çelës për promovimin e integritetit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe kohezionit shoqëror. Kjo trashëgimi është e ekspozuar ndaj një rreziku të lartë antropik për shkak të shpejtësisë me të cilën humbin dhe transformohen njohuritë, teknikat dhe materialet, por edhe, fatkeqësisht, ndaj një rreziku të lartë mjedisor, për shkak të tërmeteve, katastrofave dhe ndryshimeve klimatike në shumë vende dhe kultura që ndodhen veçanërisht në zona të brishta dhe të ekspozuara. Disiplinat bazë dhe kualifikuese për doktoratën përmbledhen përmes një sinteze të deklaratave që lidhen me sektorët disiplinorë të përfshirë.

Neni 5

5.1 Programi i Studimit të Doktoratës

Titulli akademik “Doktor” merret pas mbrojtjes së tezës, në përfundim të studimeve të doktoratës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, në përputhje me kriteret dhe brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

Çdo universitet lëshon një diplomë që vërteton dhënien e titullit Doktor, e cila lëshohet sipas rregulloreve të veta duke përmendur universitetin tjetër në cilësinë e partnerit në një doktoratë që bashkë drejtohet.

5.2 Organizimi dhe kohëzgjatja e doktoratës

Përgjegjësi i programit të studimit merret me të gjitha çështjet që lidhen me planifikimin dhe zbatimin e projektit kërkimor, duke siguruar angazhimin e stafit akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor.



Kohëzgjatja e programit të doktoratës është 3 vite akademike, që për Italinë korrespondon me një cikël, dhe 3-5 vite akademike për Shqipërinë. Zgjatja e kohëzgjatjes së tij bëhet sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.

Programi i studimit të Doktoratës zhvillohet me kohë të plotë në Njësinë bazë ose me kohë të zgjatur kur doktoranti është i punësuar si staf akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë ose si staf kërkimor në një institucion kërkimor bazë ose të aplikuar.

Gjatë rrugëtimit të programit të doktoratës, zakonisht brenda vitit të parë të programit, doktoranti nënshkruan një Marrëveshje Individuale (Shtojca 1). Universiteti i prejardhjes përcaktohet si vendi i regjistrimit të parë, ndërsa Universiteti ku bëhet mobiliteti përcaktohet si vendi i regjistrimit të dytë ose Universiteti pritës. Periudha e studimit e kërkuar në Universitetin pritës nuk mund të jetë më pak se 12 muaj (edhe në mënyrë jo të vazhdueshme).

Në fund të çdo viti, doktoranti paraqet një raport në lidhje me aktivitetet e kryera, rezultatet e arritura, pjesëmarrjen në seminare, konferenca dhe iniciativa të tjera shkencore, me botimet e mundshme dhe në përfundim të programit me tezën e doktoratës.

Organet kompetente të dy universiteteve, bazuar në vlerësimet e Mbikëqyrësve dhe bashkë-mbikëqyrësve, vlerësojnë së bashku aktivitetin e doktorantit me qëllimin që të pranohet në vitin pasardhës, sipas mënyrave të përcaktuara për të gjithë doktorantët e programit.

Në përfundim të Doktoratës, lëshohet titulli akademik “Doktor”.

5.3 Formim i thelluar në kërkim shkencor gjatë tre viteve të studimit

Aktiviteti kërkimor, bazuar në llojin e temës, mund të realizohet edhe në bashkëpunim me institucione të tjera vendase ose të huaja që sigurojnë infrastrukturën dhe stafin akademik të nevojshëm për realizimin e programit të studimit.

Aktiviteti kërkimor parashikon një punë kërkimore të pavarur nga ana e doktorantit dhe udhëheqësit të tij shkencor.

Gjatë tre viteve të studimit, doktoranti duhet të fitojë 30 kredite formuese (nga të cilat të paktën 6 dedikuar programeve të avancuara lidhur me të ashtuquajturat “aftësi transversale”), për frekuentimin e programeve të parashikuara nga programi i doktoratës dhe për pjesëmarrjen në konferenca, seminare dhe takime bazuar në ofertën arsimore të dy universiteteve. Nëse një pjesë e krediteve fitohet në Universitetin pritës, ato duhet të njihen dhe të vlerësohen nga Universiteti ku doktoranti është regjistruar fillimisht.

Neni 6

Njësia bazë dhe Udhëheqësi shkencor

6.1 Njësia bazë propozuese dhe përgjegjëse për studimet e Doktoratës miraton projektet e kërkimit shkencor për çdo doktorant, vetëm në ato fusha studimi që i përkasin programeve të miratuara të doktoratës që ajo ofron.

6.2 Njësia bazë cakton si Përgjegjës të programit të studimit një nga anëtarët e stafit akademik që ka së paku kualifikimin akademik të kategorisë “Profesor”.



6.3 Përgjegjësi i programit të studimit zgjidhet nga Njësia bazë dhe duhet të ketë kualifikimin akademik të kategorisë “Profesor”. Ai merret me çështjet që lidhen me zbatimin konkret të programit të studimit.

6.4 Udhëheqësi shkencor i doktorantit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin dhe vlerësimin e progresit të doktorantit.

6.5 Udhëheqësi shkencor i doktorantit duhet të ketë kualifikimin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”.

6.6 Në rastet kur një pjesë e studimeve të doktoratës kryhet në një Institucion të Arsimit të Lartë në një nga vendet e Bashkimit Evropian, Kanadasë ose SHBA-së, bashkë-udhëheqësi i Institucionit partner mund të ketë edhe kualifikimin akademik “Doktor”.

6.7 Nëse Udhëheqësi shkencor nuk mund të sigurojë mbikëqyrjen e doktorantit për një periudhë kohore, madje edhe të gjatë, ose nëse marrëdhënia ndërmjet doktorantit dhe Udhëheqësve shkencorë nuk është e mirë, Përgjegjësi i programit të studimit e zëvendëson atë me një Udhëheqës tjetër shkencor që plotëson kriteret për të qenë i tillë.

6.8 Njësia bazë krijon një Këshill të posaçëm, i cili në mënyrë periodike kontrollon dhe vlerëson aktivitetin vjetor të kërkimit shkencor të doktorantëve.

6.9 Njësia kryesore ka detyrën të hartojë rregulloren e brendshme mbi kriteret, procedurat dhe mënyrat e mbrojtjes së tezës së doktoratës.

6.10 Udhëheqësi shkencor dhe Përgjegjësi i programit të studimit të Doktoratës mblidhen gjatë vitit për të diskutuar ecurinë dhe çështjet që lidhen me organizimin dhe zbatimin e programit të studimit.

6.11 Numri i doktorantëve që një Tutor shkencor mund të ndjekë caktohet nga Njësia bazë, ndërsa projekti kërkimor i çdo doktoranti përcaktohet në përputhje me projektet kërkimore të Njesisë bazë.

Studimet e doktoratës zhvillohen në grupe kërkimore, të udhëhequra nga stafi akademik i kategorisë “Profesor”. Numri i doktorantëve në përbërje të çdo grupi kërkimor duhet të jetë:

- a) jo më shumë se 7 (shtatë), në rastin e stafit akademik me kualifikimin “Profesor”;
- b) jo më shumë se 5 (pesë), në rastin e stafit akademik me kualifikimin “Profesor i Asociuar”;
- c) jo më shumë se 3 (tre), në rastin e stafit akademik me kualifikimin “Profesor”, por i angazhuar në kohë të pjesshme (part-time).

Neni 7

Procedurat për dorëzimin e kërkesës për pranimin në programin e studimit të Doktoratës

Kandidatët që paraqesin kërkesë për pranim në programin e studimit të ciklit të III-të “Doktoratë”, duhet të dorëzojnë dosjen individuale, e cila duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

- a. Kërkesë e kandidatit e adresuar Dekanit të Fakultetit, e depozituar pranë sekretarisë së Njesisë bazë që ofron programin e studimit.
- b. Curriculum Vitae (CV) e kandidatit, ku përfshihet arsimi i lartë, kualifikimet dhe karriera universitare e mëparshme ose aktivitete të tjera akademike-shkencore.



- c. Kopje e noterizuar e diplomës “Master Shkencor”, diplomës të përfituar sipas sistemit të vjetër 4-vjeçar, e programeve të integruara të ciklit të dytë (DIND), ose diplomë tjetër ekuivalente me to, të pajisur me listën e notave ose me “Suplementin e Diplomës”. Diploma e marrë jashtë shtetit duhet të jetë e shoqëruar me vërtetimin e njehsimit të lëshuar nga Ministria e Arsimit. Diplomat e përfituara në universitete të huaja duhet të deklarohen ekuivalente nga Ministria e Arsimit.
- d. Kopje e noterizuar e diplomave ose certifikatave për kualifikime të tjera, nëse kandidati zotëron të tilla.
- e. Kërkesë për fushën specifike të kërkimit, lidhur me programin përkatës të doktoratës.
- f. Kopje e noterizuar e kartës së identitetit ose pasaportës.
- g. Dy fotografi në format (pasaporte).
- h. Dy rekomandime nga profesorë të njohur të fushës së studimit me kualifikime akademike.
- i. Certifikata ndërkombëtare për njohjen e një prej pesë gjuhëve të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse kandidati zotëron një diplomë të një programi studimi që është zhvilluar në njërin nga këto pesë gjuhë, ajo diplomë shërben si dëshmi e njohjes së gjuhës.
- j. Certifikatë nga zyra e punësimit, nëse kandidati është i punësuar.
- k. Mandat pagesa për tarifën e aplikimit prej 2000 Lekë ALL.

Kandidati, në momentin e dorëzimit të kërkesës, nuk duhet të jetë duke ndjekur ndonjë program tjetër studimi. Nëse konstatohet e kundërta, përgjegjësia bie mbi të.

Kërkesa që nuk përmban dokumentacionin e sipërpërmendur nuk do të merret në konsideratë.

Dosja individuale e kandidatit dorëzohet në sekretarinë e Njesisë bazë që ofron programin përkatës të studimit.

Neni 8

Kriteret e pranimit në programin e Doktoratës

8.1 Kandidati duhet të posedojë një “Master Shkencor” të përfituar pranë Universitetit UKZKM, pranë universiteteve publike ose jopublike shqiptare të akredituara, si në nivel institucional, ashtu edhe për programin përkatës të studimit në momentin e marrjes së diplomës; ose pranë çdo universiteti tjetër të njohur nga autoritetet përkatëse.

8.2 Diploma e fituar duhet të jetë në një nga fushat e mëposhtme:

- Arkitekturë
- Inxhinieri
- Histori
- Arkeologji

8.3 Kandidati duhet të zotërojë dhe të certifikojë njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të BE-së: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse kandidati posedon një diplomë nga një program studimi i zhvilluar në njërin prej këtyre pesë gjuhëve, kjo diplomë shërben si certifikatë njohjeje.



8.4 Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nëpërmjet vlerësimit, bazuar në karrierën studimore të kandidatit, kërkimin shkencor dhe aktivitetin e mundshëm akademik.

8.5 Faza e dytë e përzgjedhjes konsiston në një intervistë, gjatë së cilës kandidati do të paraqesë projektin e kërkimit, duke dëshmuar njohuri themelore mbi të menduarit krijues dhe kritik. Në intervistë do të pranohen vetëm kandidatët që do të rezultojnë të kualifikuar në vlerësimin e titujve sipas pikës 8.4.

Në përfundim të intervistës, përgjegjësi i programit të studimit, së bashku me 2 (dy) anëtarë të stafit akademik të njësisë kryesore, do të hartojë një renditje përfundimtare me vlerësimin final të kandidatëve.

Pas publikimit të listës së fituesve, kandidatët regjistrohen në sekretaritetë përkatëse.

Kandidatët e përzgjedhur, para regjistrimit në programin e studimeve të doktoratës, duhet të paguajnë tarifën përkatëse, urdhrin e pagesës së cilës e paraqesin në momentin e regjistrimit.

Kandidatëve të pakualifikuar, dosja individuale që përmban dokumentacionin u kthehet pas paraqitjes së kërkesës për tërheqjen e dokumenteve.

Neni 9.

Procedurat e regjistrimit të kandidatëve

Pas publikimit të renditjes përfundimtare të kandidatëve të përzgjedhur, e cila publikohet në ambiente të dukshme të Fakultetit dhe në faqet zyrtare të Universitetit, kandidati duhet të dorëzojë në sekretaritet mësimore dokumentacionin e mëposhtëm për qëllim të regjistrimit:

- Kopje e noterizuar e diplomës “Master Shkencor” ose e diplomës së marrë në përfundim të sistemit të mëparshëm 4-vjeçar, e diplomës së programeve të studimit të ciklit të dytë të integruar (DIND), ose e një diplomë tjetër ekuivalente me këto, e shoqëruar me listën e notave ose suplementin e diplomës. Diploma e marrë jashtë shtetit duhet të ketë certifikatën e njehsimit të lëshuar nga Ministria e Arsimit. Diplomat e marra në universitetet e huaja duhet të deklarohen ekuivalente nga Ministria e Arsimit.
- Certifikatat ndërkombëtare të njohjes së njërës prej pesë gjuhëve të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse kandidati zotëron një diplomë të një programi studimi të zhvilluar në njërën prej këtyre pesë gjuhëve, ajo diplomë në këtë rast shërben si certifikatë.
- Kandidatët fitues paguajnë tarifën përkatëse (e specifikuar në thirrjen për konkurs) për regjistrimin në programin e doktoratës ku janë shpallur fitues, dhe mandati i pagesës paraqitet në sekretari në momentin e regjistrimit.
- Kopje e noterizuar e kartës së identitetit ose e pasaportës.
- Dy foto në format pasaporte.
- Në rast se ndonjë kandidat tërhiqet para fillimit të programit të Doktoratës, kuota e lirë i ofrohet kandidatit pasardhës më poshtë në renditje.
- Nënshkrimin e një Marrëveshjeje Individuale sipas modelit të bashkëngjitur në thirrje (Shtojca 1).



Neni 10

Publikime

Kriteret, procedurat, dokumentacioni dhe afatet për konkursin e pranimit në programin e studimit të Doktoratës paraqiten në thirrjen përkatëse të publikuar në faqen zyrtare të Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” të paktën një muaj para afatit të parashikuar për dorëzimin e aplikimeve.

Neni 11

Nënshkrimi i kontratës ndërmjet studentit dhe Institucionit që ofron programin e Doktoratës

11.1 Para fillimit të programit të Doktoratës, kandidati i përzgjedhur duhet të nënshkruajë një kontratë të shkruar për të formalizuar marrëdhënien ndërmjet tyre.

11.2 Në marrëveshjen e sipërpërmendur përcaktohen përgjegjësitë e palëve, të drejtat dhe detyrimet në lidhje me financimin, udhëheqjen, marrëdhëniet dhe pronësinë e rezultateve të kërkimit.

11.3 Në rast të shkëputjes së kontratës, ndërprerja e projektit kërkimor do t’i propozohet Këshillit të Doktoratës nëse kandidati ndërpret studimet e Doktoratës para përfundimit të tyre, dhe si pasojë kjo shënon edhe zgjidhjen e kontratës.

Neni 12

Këshilli i Doktoratës

Për të garantuar një ecuri të mirë të aktivitetit të kërkimit shkencor si dhe cilësinë e tij, me vendim të Njesisë Bazë themelohet dhe vepron "Këshilli i Doktoratës", i përbërë nga Përgjegjësi i programit të studimit dhe Udhëheqësit shkencorë të çdo studenti.

Neni 13

Të drejtat dhe detyrimet e doktorantit

13.1 Doktoranti ka të drejtë:

- të kërkojë infrastrukturën e duhur për të ndjekur të gjitha aktivitetet e parashikuara nga programi i studimit;
- të punojë në ambientet e vëna në dispozicion dhe të përdorë të gjitha pajisjet dhe mjetet përkatëse;
- të përdorë bibliotekën e Universitetit ose të Njesisë Bazë;
- të tërhiqet vullnetarisht nga programi i Doktoratës me anë të një kerkese të shkruar paraprake;



- të informohet që në fillim për:
 - llojin dhe kufizimet kërkimore të doktoratës;
 - facilitetet (përfshirë mbështetjen për punën në terren, nëse është e nevojshme) që ofrohen nga Universiteti dhe institucionet e tjera të përfshira;
 - përmasat e projektit, afatin e parashikuar për përfundimin e tij;
 - cilësitë dhe aftësitë e pritshme nga Universiteti për kualifikimin e tij. Hartimin e një plani për të fituar kompetenca të reja gjatë rrugëtimit të tij të kualifikimit me mbështetjen e Përgjegjësit.
- të konsultohet rregullisht me Drejtorin Shkencor që nga fillimi si dhe në periudha të përshtatshme, sipas marrëveshjes, dhe ta informojë për aktivitetin kërkimor, progresin dhe problemet e hasura;
- të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme kërkimore të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën zhvillon studimet e doktoratës;
- të marrë pjesë lirshëm në aktivitetet e doktoratës që zhvillohen jashtë punës së tij kërkimore, si seminare, diskutime pas diplomimit, debate ndërdisiplinore, konferenca, projekte kërkimore edhe nëse nuk lidhen me objektin kërkimor të doktorantit.

13.2 Doktoranti duhet:

- të njohë rregulloren e programit të doktoratës dhe kuadrin ligjor përkatës (VKM, Urdhrat e Ministrisë së Arsimit);
- të përmbushë detyrimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, vendimet, dekretet dhe rregulloret;
- të përfundojë projektin kërkimor të doktoratës;
- të arrijë rezultate të mira gjatë kryerjes së programit të Doktoratës;
- të kryejë në kohë të gjitha pagesat e parashikuara ndaj Universitetit (Fakultetit), si dhe të përmbushë të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga regjistrimi dhe ndjekja e Doktoratës;
- të paraqesë një raport të paktën një herë në vit mbi ecurinë e projektit;
- të zbatojë standardet shkencore dhe etike të parashikuara;
- të përfundojë projektin kërkimor shkencor dhe mbrojtjen e tezës së doktoratës brenda afateve të përcaktuara.

Doktoranti duhet t'i paraqesë Udhëheqësit të tij shkencor, në periudha të përcaktuara, një pjesë të rëndësishme të punës së tij kërkimore në formë të shkruar (si raport, draft kapitulli, etj.). Doktoranti dhe Udhëheqësi shkencor mund të bëjnë një vlerësim të përmbledhur të punës së kryer të paktën çdo gjashtë muaj.

- të arrijë rezultate të mira për studimet e doktoratës;
- të raportojë, të paktën një herë në vit, tek Njësia bazë e programit (departamenti ose grupi shkencor-didaktik) mbi ecurinë e kërkimit shkencor dhe realizimin e programit;



Në hartimin e tezës doktoranti duhet të:

- Njohë literaturën në fushën e interesit specifik dhe ta vlerësojë në mënyrë kritike;
- Formulojë një hipotezë të qartë, ose një temë të përgjithshme dhe të mbështesë rezultatet me të dhëna dhe analiza adekuate;
- Përgatisë versionin përfundimtar të tezës pa gabime, të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme;
- Shmangë plagjiaturën, përfshirë kopjimin e drejtpërdrejtë të materialeve, përdorimin e të dhënave ose ideve të tjerëve pa leje;
- Shmangë përfshirjen e personave që nuk kanë kontribuar në mënyrë reale në kërkimin shkencor.

Neni 14

Përgjegjësitë e Udhëheqësit shkencor të doktorantit

Udhëheqësi shkencor i doktorantit duhet të ketë kualifikimin akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” dhe mund të jetë udhëheqës për një numër të limituar studentësh në të njëjtën kohë, duke përfshirë edhe udhëheqjen në institucione të tjera të arsimit të lartë ku është i angazhuar.

Udhëheqësi shkencor i doktorantit është përgjegjës për udhëheqjen, këshillimin, vlerësimin dhe ecurinë e doktorantit.

Udhëheqësi shkencor duhet të garantojë realizimin e të gjitha aktiviteteve të udhëheqjes së doktoratës.

Udhëheqësi shkencor duhet të sigurojë pjesëmarrjen e rregullt të doktorantit në grupin e kërkimit shkencor.

Udhëheqësi shkencor duhet ta orientojë doktorantin drejt burimeve të informacionit, materialeve të studimit dhe teksteve shkencore të fushës përkatëse të studimit.

Udhëheqësi shkencor e këshillon doktorantin për detyrat mësimore dhe metodologjinë kërkimore.

Udhëheqësi shkencor e orientojnë dhe e këshillon doktorantin për konferencat dhe aktivitetet shkencore që zhvillohen brenda dhe jashtë vendit, duke e ndihmuar në përgatitjen për pjesëmarrje në këto aktivitete.

Udhëheqësi shkencor planifikon takime periodike (të paktën një herë në muaj) me doktorantin për të vlerësuar progresin dhe për të përcaktuar objektivat afatshkurtra dhe afatgjata të kërkimit shkencor, metodologjinë që do të ndiqet dhe përmirësimet që duhet të bëhen për të siguruar vazhdimësinë e punës.

Udhëheqësi shkencor garanton që doktoranti të marrë mbështetjen dhe udhëzimet e nevojshme për të arritur rezultate optimale në përfundim të kërkimit shkencor.

Udhëheqësi shkencor duhet të vlerësojë rregullisht progresin e doktorantit duke i kërkuar atij të paraqesë një raport me shkrim dhe të monitorojë punën e tij në përputhje me standardet e kërkuara.

Udhëheqësi shkencor duhet ta bëjë të vetëdijshëm doktorantin kur aktiviteti i tij kërkimor është nën nivelin e standardit të kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet mbështetëse të nevojshme.

Udhëheqësi shkencor duhet të sigurohet që doktoranti ka përmbushur të gjitha kërkesat dhe vërejtjet e jurisë në përfundimin e tezës së doktoratës, në rast se kjo i është kthyer për tu dorëzuar përsëri.



Udhëheqësi shkencor duhet të sigurohet që doktoranti përfundon studimet e doktoratës brenda afateve të parashikuara.

Universiteti siguron që Udhëheqësi shkencor të ketë kohë të mjaftueshme për të mbikëqyrur studentin e doktoratës;

- a) Nëse Udhëheqësi shkencor nuk është në gjendje të vazhdojë mbikëqyrjen e doktorantit ose mungon për një periudhë relativisht të gjatë, ai duhet të zëvendësohet nga një tjetër Udhëheqës përpara periudhës së mbrojtjes së tezës për marrjen e titullit shkencor “Doktor”;
- b) Nëse marrëdhënia ndërmjet doktorantit dhe Udhëheqësit nuk është e mirë, me kërkesë të doktorantit ose të mbikëqyrësit të tij, Udhëheqësi shkencor duhet të ndryshohet, me kusht që kjo të mos ndikojë në zbatimin dhe ecurinë e projektit;
- c) Në rastet e bashkë-udhëheqjes, përgjegjësitë duhet të jenë të qarta për të dyja palët dhe ato duhet të mbajnë kontakte të rregullta.

Neni 15

Programi i doktoratës dhe vlerësimi i progresit të doktorantit

Udhëheqësi shkencor, së bashku me doktorantin, hartojnë një program kërkimor trevjeçar, i cili duhet të miratohet nga Përgjegjësi i programit të studimit.

Gjatë programit të Doktoratës, mund të parashikohen seminare teorike formimi (jo më shumë se 6, me një ngarkesë totale prej 12 orësh), që kanë të bëjnë me aspekte të fushës kërkimore të doktoratës në vitin e parë të studimeve.

Doktorantët ndjekin me rregullsi aktivitetet kërkimore, studimore dhe didaktike sipas mënyrave të përcaktuara nga të dy Universitetet dhe nga Mbikëqyrësit dhe bashkë-mbikëqyrësit përkatës. Gjatë periudhës trevjeçare, ata duhet të fitojnë 30 kredite formuese (ku një kredit është ekuivalent me 6 orë), për ndjekjen e programeve të parashikuara nga programi i doktoratës dhe për pjesëmarrjen në konferenca, seminare dhe takime. Gjashtë nga 30 kreditë duhet t’i kushtohen programeve të avancuara që lidhen me të ashtuquajturat “aftësi transversale”. Programet dhe kreditet përkatëse mund të fitohen në të dy universitetet, por duhet të njihen dhe të vlerësohen nga Universiteti i regjistrimit të parë.

Në fund të çdo viti, doktorantët përgatisin një raport të detajuar me shkrim. Organet kompetente të dy Universiteteve, mbi bazën e vlerësimeve të Mbikëqyrësve dhe bashkë-mbikëqyrësve, vlerësojnë së bashku aktivitetin e doktorantit për qëllime të pranimit në vitin pasues, sipas mënyrave të përcaktuara për të gjithë doktorantët e programit.

Neni 16

Marrja e titullit akademik “Doktor”

Pas mbrojtjes së tezës të doktoratës, doktoranti dorëzon një kopje në Bibliotekën Kombëtare, një kopje në bibliotekën shkencore të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe një kopje në sekretarinë mësimore



të Fakultetit përkatës. Diploma për kualifikimin shkencor "Doktor" nuk lëshohet pa u depozituar teza në format të letër dhe në CD në institucionet e sipërpërmendura, si dhe nëse nuk është publikuar në faqen zyrtare të Institucionit të Arsimit të Lartë përkatës;

Dosja e plotë e doktorantit ruhet në Arkivin e Universitetit dhe përfshin një kopje të tezës së doktoratës.

Diploma e Doktoratës nuk lëshohet pa qenë më parë e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Doktoratave të Komisionit të Vlerësimit të Kualifikimeve Akademike pranë Ministrisë së Arsimit.

Universiteti i Firences jep titullin Doktor në: “Arkitekturë, Projekti, Njohja dhe Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore”.

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" jep titullin Doktor në: “Arkitekturë Mesdhetare: Projekt, Njohja dhe Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore”.

Në përfundim të mbrojtjes së tezës së doktoratës, doktorantit i jepet titulli shkencor "Doktor".

Secili nga universitetet lëshon një diplomë që vërteton dhënien e titullit "Doktor", të lëshuar sipas rregulloreve të tij, duke përfshirë referencën për universitetin tjetër si partner në një program doktorate me bashkë-udhëheqje të temës së doktoratës.

Neni 17

Formati i tezës

17.1 Doktoranti përgatit tezën sipas formatit të miratuar në këtë rregullore. Teza duhet të sjellë inovacion teorik dhe/ose empirik në fushën përkatëse të kërkimit dhe të kontribuojë në progresin e njohurive shkencore.

Teza përgatitet në 3 (tre) kopje në gjuhën italiane dhe shoqërohet me një përmbledhje në gjuhën italiane, angleze dhe shqipe, si dhe me 2 (dy) kopje të përmbledhjes së saj (2000-4000 fjalë) në gjuhën angleze, frënge, gjermane, italiane ose spanjolle në format të shtypur dhe elektronik. Teza miratohet nga Drejtori shkencor para dorëzimit.

17.2 Kopertina e tezës dhe faqja e parë do të jenë faqja e titullit që i dorëzohet doktorantit nga sekretaria.

17.3 Format i tezës së Doktoratës është zgjedhje e lirë e doktorantit.

Neni 18

Etika në kërkim shkencor

Kur dorëzon tezën, doktoranti duhet të deklarojë me shkrim se studimi është një punë origjinale e tij.



Doktoranti nuk mund të dorëzojë një dokument që ka paraqitur ose publikuar më parë në revista shkencore ose në ngjarje përpara fillimit të doktoratës.

Plagjiatura nënkupton përdorimin e ideve dhe termave nga publikimet e një personi tjetër pa dhënë "referencat" përkatëse. Për këtë arsye, përdorimi i ideve ose punës së të tjerëve duhet të reflektohet në tekste ose referenca.

Të gjitha citimet e nxjerra nga puna e të tjerëve duhet të vendosen në thonjëza dhe të shënohet burimi.

Nëse pjesët e marrë nga të tjerët janë më të gjata se 5 rreshta, ato nuk futen në thonjëza, por për to duhet të tregohen referencat përkatëse.

Nëse burimi origjinal është i paarrtshëm, por përmendet në një dokument tjetër, duhet të jepen të dy dokumentet, si burimi origjinal ashtu edhe burimi dytësor.

Udhëheqësit duhet të sqarojnë në fillim të punës së tyre se asnjë formë mashtrimi, falsifikimi dhe plagjiature nuk do të tolerohet, përkundrazi, parashikohen sanksione.

Pronësia intelektuale dhe e drejta e autorit të veprës (ashtu si për materialin e publikuar) mbrohen nga ligji për të drejtat e autorit. Njoftimi i të drejtës së autorit, simboli përkatës ©, emri i mbajtësit të të drejtës së autorit dhe viti i botimit duhet të përfshihen në faqen pas titullit të veprës.

Neni 19

Kriteret për marrjen e kualifikimit akademik "Doktor".

Para mbrojtjes së tezës së doktoratës, doktoranti duhet të:

- a) ketë realizuar si autor i parë ose i dytë (kur autori i parë është Udhëheqës shkencor), të paktën 3 (tre) prezantime, 2 (dy) prej të cilave të jenë zhvilluar në aktivitete shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OSBE-së ose G20, të pranuar në bazë të një vlerësimi të mëparshëm shkencor dhe të botuara në "Proceedings", me kod ISBN ose ISSN;
- b) ketë botuar të paktën 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, 2 (dy) prej të cilëve të jenë botuar ose pranuar për botim në revista të indeksuara të vendeve të OSBE-së, BE-së ose G20, me komitet redaktues, ku të paktën njëri është autor i parë dhe tjetri autor i dytë.



Neni 20
Mbrojtja e tezës së doktoratës.

20.1 Teza vlerësohet nga kontributi i rezultateve të arritura dhe nga progresi i kompetencave të reja teorike që ajo sjell në fushën përkatëse të kërkimit shkencor, nga risitë, nga zbatueshmëria e saj dhe nga pozicioni që zë në përmbushjen e nevojave të shkencës dhe disiplinës. Teza duhet të ketë një nivel të lartë akademik, në mënyrë që të justifikojë botimin e saj në fushën përkatëse.

20.2 Provimi përfundimtar konsiston në një mbrojtje publike të tezës përpara komisionit.

20.3 Doktoranti dorëzon në sekretari kërkesën për pranimin e tezës së doktoratës, të nënshkruar nga Drejtori shkencor.

Pranimi i doktorantit në provimin përfundimtar kushtëzohet nga vlerësimi pozitiv i organeve kompetente të të dy universiteteve, pas marrjes së mendimit të Mbikëqyrësve dhe bashkë-mbikëqyrësve.

Doktoranti dorëzon tezën së bashku me dosjen te Dekani i Njesisë kryesore, i cili e përcjell vlerësimin te Njësia bazë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes.

Pas vlerësimit nga Njësia bazë, teza dhe dosja e kandidatit dërgohen te Komisioni i Dhënies së Kualifikimit Akademik “Doktor” brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

Komisioni gjykues emërohet në mënyrë të përbashkët nga Rektorët e dy Universiteteve në mënyrë të barabartë dhe përbëhet nga tre anëtarë të emëruar nga secili universitet. Dy Mbikëqyrësit bëjnë pjesë në komisionin e provimit, i cili përbëhet sipas rregullave të të dyja vendeve.

Në rast të një vlerësimi pozitiv, kolegji i pedagogëve emëron dy vlerësues jashtë Palëve, me kualifikim të lartë, prej të cilëve të paktën njëri është profesor ose kërkues universitar. Vlerësuesit mund të jenë pjesë e institucioneve ndërkombëtare të huaja.

Vlerësuesit shqyrtojnë tezën, së bashku me raportin mbi aktivitetet e kryera gjatë programit të doktoratës dhe mbi publikimet e mundshme, dhe brenda tridhjetë ditëve nga marrja e dokumentacionit japin një vlerësim analitik me shkrim, duke propozuar pranimin për mbrojtje publike të tezës ose shtyrjen për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj nëse konsiderojnë të nevojshme plotësime ose korrigjime. Pas përfundimit të kësaj periudhe, teza në çdo rast pranohet për mbrojtje publike, e shoqëruar me një opinion të ri nga të njëjtët vlerësues.

Provimi zhvillohet brenda 45 ditëve nga vlerësimi pozitiv i vlerësuesve, ose brenda gjashtë muajve në rast se vlerësuesit kanë konsideruar të nevojshme korrigjime ose plotësime të tezës.

Komisioni, nëse vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve formon një juri për vlerësimin e tezës. Juria cakton datën e diskutimit të tezës së doktoratës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj.



Teza mbrohet para jurisë. Pas përfundimit të mbrojtjes, juria jep një vlerësim të shkruar dhe të arsyetuar për tezën, dhe kur të njoh në mënyrë unanime meritat e veçanta shkencore, mund t'i atribuojë lavdërimet (lode). Juria dërgon raportin e shkruar te Dekani i Njesisë kryesore. Nëse teza vlerësohet si e papërshtatshme, provimi nuk mund të përsëritet.

Diploma për kualifikimin akademik "Doktor" jepet nga Dekani i Njesisë kryesore dhe Rektori.

Mospjesëmarrja e paarsyeshme në provim sjell humbjen e mundësisë për të marrë titullin.

20.4 Mbrojtja e tezës së doktoratës përbëhet nga:

- a) Përgatitja e një teze origjinale në fushën e interesit të përcaktuar më parë, me karakter personal. Teza duhet të përgatitet sipas formatit të përcaktuar në këtë rregullore.
- b) Prezantimi publik i tezës, duke nxjerrë në pah cilësitë, origjinalitetin e kërkimit shkencor dhe aftësinë e prezantimit në *auditor*.

20.5 Mbrojtja e tezës kalon në këto etapa:

- a) Kryetari i jurisë paraqet dokumentacionin e dosjes, përbërjen e jurisë dhe miratimin e saj për fillimin e mbrojtjes së tezës;
- b) Doktoranti bën prezantimin e tezës për 20-25 minuta përmes një prezantimi në format PowerPoint;
- c) Prezantimi i kundërshtimeve (nga vlerësuesit);
- d) Pyetje nga të pranishmit dhe ndërhyrje nga vlerësuesit e tezës;
- e) Debate, sqarime dhe replika nga doktoranti dhe Drejtori shkencor;

Nëse teza vlerësohet si e pamjaftueshme, provimi nuk mund të përsëritet.

Neni 21

Juria dhe vlerësuesit në mbrojtjen e Doktoratës.

21.1 Komisioni për Dhënien e Kualifikimit Akademik "Doktor", i cili monitoron të gjithë procesin, përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë të Njesisë kryesore ku ofrohet programi i doktoratës, të cilët i përkasin kategorisë "Profesor".

21.2 Juria e Doktoratës krijohet nga Komisioni për Dhënien e Kualifikimit Akademik "Doktor" dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, prej të cilëve të paktën 1 (një) anëtar i jashtëm që nuk i përket Njesisë bazë, por punon



në institucione homologe, lokale ose të huaja, dhe 2 (dy) vlerësues të caktuar për vlerësimin e tezës, prej të cilëve njëri është jashtë Njesisë bazë. Anëtarët e jurisë propozohen nga Njësia bazë me miratimin e Dekanit të Njesisë kryesore. Numri i anëtarëve të propozuar nuk duhet të jetë më pak se 8 (tetë).

21.3 Anëtarët e komisionit vlerësues propozohen nga Njësia bazë me miratimin e Dekanit të Fakultetit përkatës. Rektori i UKZKM-së miraton jurinë me një urdhër të posaçëm.

21.4 Nuk emërohen vlerësues që janë të përfshirë në mënyrë thelbësore në punën e doktorantit ose punën e të cilëve ka të njëjtin fokus me projektin kërkimor.

21.5 Udhëheqësi shkencor i doktorantit nuk duhet të jetë në cilësinë e vlerësuesit.

21.6 Një kopje e tezës i dorëzohet çdo vlerësuesi, duke i dhënë kohën e nevojshme për ta lexuar dhe për të përgatitur një raport ku përshkruhet se puna në përgjithësi përmbush kërkesat e programit të doktoratës, duke evidentuar pikat e forta dhe të dobëta të tezës dhe duke nxjerrë në pah tiparet e origjinalitetit të punës së paraqitur.

21.7 Vlerësuesit duhet gjithashtu të verifikojnë autenticitetin e të dhënave të përdorura në tezë, respektimin e praktikës kërkimore dhe gjithashtu citimet e punëve kërkimore dhe ato të nxjerra nga artikuj të tjerë të autorëve të ndryshëm.

21.8 Vlerësuesit shprehen qartë për praninë ose mungesën e plagjiaturës në kërkimin shkencor. Nëse konstatojnë se plagjiatura ka ndodhur, kërkojnë ndërprerjen e vlerësimit të tezës;

21.9 Vlerësuesit dorëzojnë një kopje të raporteve të tyre të shkruara individualisht te Dekani i Njesisë bazë që organizon kursin e doktoratës dhe te Dekani i jurisë;

21.10 Diskutimi i tezës së doktoratës zhvillohet në praninë e gjithë jurisë, jo më herët se një muaj pas datës së miratimit të saj.

21.11 Nëse një prej anëtarëve të jurisë nuk mund të jetë i pranishëm në ditën e caktuar për mbrojtjen e tezës pa arsye të ligjshme, Përgjegjësi i programit informon Dekanin. Nëse Dekani nuk miraton një datë tjetër për mbrojtjen e tezës, anëtari i jurisë zëvendësohet me një tjetër me të njëjtin cilësi.

Neni 22

Vlerësimi i tezës

22.1 Për vlerësimin e tezës, juria merr në konsideratë edhe raportet e shkruara, të përgatitura nga vlerësuesit mbi pikat e forta dhe të dobëta të tezës së kërkimit shkencor.



22.2 Juria vlerëson kryesisht nëse materiali dhe metoda e përdorur në kërkimin shkencor janë të përshtatshme për të arritur objektivat e tezës së doktoratës dhe nëse përfundimet dhe rezultatet e arritura nga kërkimi kanë një bazë shkencore.

22.3 Përveç vlerësimit të tezës, juria gjithashtu vlerëson:

- a. Gamën e njohurive të doktorantit në fushën shkencore përkatëse;
- b. Aftësinë e doktorantit për përdorimin e teknologjisë bashkëkohore për të zgjidhur problemet dhe kritikën që lidhen me fushën e tij të kërkimit shkencor;
- c. Pavarësinë, integritetin shkencor, profesional dhe angazhimin e doktorantit për zbatimin e ideve të reja që promovojnë kërkimin shkencor;
- d. Objektivat dhe qëllimet e doktorantit për të vazhduar kërkimet në fushën e studimit përkatëse;
- e. Risitë e kërkimit, zbatueshmërinë e tij dhe rëndësinë që ka për nevojat aktuale dhe të ardhshme të shkencës.

22.4 Vlerësimi i jurisë është sekret dhe bëhet me pikë. Secili anëtar ka në dispozicion 10 pikë për vlerësimin maksimal të kandidatit. Teza vlerësohet me një sistem pikësh nga 0 në 100 pikë. 100-80% e pikëve = “shumë mirë”, 79-65% e pikëve = “mirë”, 64-50 % e pikëve = “mjaftueshëm”, 49% dhe më pak pikë = “pamjaftueshëm”.

22.5 Juria duhet të përgatisë një raport të shkruar duke marrë parasysh që:

- a. Pranon mbrojtjen publike të tezës.
- b. Nuk pranon mbrojtjen publike të tezës, por lejon përmirësimin e saj.
- c. Nuk e pranon (e refuzon) tezën.

Neni 23

Shtyrja e tezës

23.1 Nëse juria konstaton se teza ka nevojë për korrigjime dhe plotësime, dhe për këtë arsye nuk lejon mbrojtjen e saj, këto korrigjime dhe plotësime duhet të realizohen brenda 6 muajve nga data e shtyrjes.

23.2 Juria duhet të caktojë afatin për dorëzimin e tezës së korrigjuar në marrëveshje me doktorantin dhe Drejtuesin shkencor. Vetëm teza e korrigjuar konsiderohet zyrtare dhe dorëzohet në institucionet dhe zyrat përkatëse.

23.3 Nëse juria vendos të refuzojë plotësisht tezën e paraqitur, doktoranti duhet të paraqesë një tezë të re, të ndryshme nga ajo e mëparshme, në mënyrë që juria të kryejë një vlerësim të ri. Në këtë rast, juria lejon që teza e re të paraqitet vetëm një herë.



23.4 Teza e re duhet të paraqitet pas 12 muajve nga vendimi i jurisë.

23.5 Kur paraqitet teza e korigjuar ose teza e re (në rastet e refuzimit), ajo duhet të vlerësohet nga e njëjta juri, përveç rasteve të veçanta.

23.6 Për arsye të ligjshme, si shëndetësore apo fatkeqësi familjare të doktorantit, Këshilli i Doktoratës mund të shtyjë mbrojtjen e tezës, por jo më shumë se 12 muaj, me kusht që të paraqitet një kërkesë paraprakisht.

Neni 24

Pezullimi i tezës së doktoratës

Pezullimi i procedurës së mbrojtjes së tezës së doktoratës mund të realizohet në rastet e mëposhtme:

a) Doktoranti paraqet një kërkesë për shtyrjen e datës së mbrojtjes së tezës së doktoratës, duke sqaruar saktësisht arsyen. Kërkesa i drejtohet Dekanit të Njesisë bazë ku zhvillohet programi i doktoratës. Dekani informon Përgjegjësin e programit të studimit, jurinë dhe Udhëheqësin për pezullimin e procedurës. Në këtë rast, lejohet përsëritja vetëm një herë e procedurës, duke marrë parasysh rezultatet aktuale të punës së doktorantit.

b) Udhëheqësi shkencor paraqet dorëheqjen për arsye të ligjshme, si: arsye shëndetësore, rezultate jo premtuese të arritura nga doktoranti, pavarësisht punës së Tutor-it, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e punës.

Në këto raste, diskutimi i tezës së doktoratës shtyhet për një periudhë që nuk e kalon 12 muaj nga data e parashikuar.

Neni 25

Heqja e titullit akademik “Doktor”.

Titulli akademik “Doktor” mund të revokohet në çdo moment dhe rrethanë, nëse konstatohet plagjiaturë ose falsifikim i të dhënave në tezën e doktorantit. Në këtë rast, Dekani i kërkon Njesisë bazë dhe Përgjegjësit të programit të doktoratës të thërrasin një mbledhje dhe të shqyrtojnë rastin e konstatuar. Vendimi i Njesisë bazë shqyrtohet nga Komiteti Etik, i cili i propozon Rektorit revokimin e titullit akademik “Doktor” të marrë nga doktoranti. Rektori, pasi e shqyrton çështjen, merr vendimin dhe ia komunikon këtë vendim Komisionit për Dhënien e Titullit Akademik “Doktor”, për të proceduar me fshirjen e regjistrimit nga regjistri përkatës i këtij Komisioni.

Personi në fjalë ka të drejtë të shpjegojë pozicionin e tij/saj përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Neni 26



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

Gjuha në të cilën bëhet mbrojtja e doktoratës është italishtja.

Dekani i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara,

Prof. Fabio Capanni